

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport analizon rezultatet e anketës me profesionistët e linjës së parë në fushën e migrimit që është realizuar nga konsorciumi i projektit PERCEPTIONS ndërmjet tetorit dhe dhjetorit të vitit 2020. Profesionistët e linjës së parë janë identifikuar në bazë të një hulumtimi për migrim (Bayerl et. al, 2020)) dhe ky raport ka për qëllim të ndihmojë në adresimin e mangësive që ekzistojnë në këtë fushë. Rezultatet, po ashtu, synojnë të shërbejnë si pikë referimi për politikëbërjen dhe hulumtimet e ardhshme për migrim. Në kuadër të projektit PERCEPTIONS, njohuritë e prezantuara në këtë raport do të ndihmojnë në informim për krijimin e materialeve në mbështetje të migrantëve dhe profesionistëve.

Ndër qëllimet kryesore të anketës ishin hulumtimi i perceptimeve për Evropën në bazë të vëzhgimeve të profesionistëve të linjës së parë ndaj migrantëve, se si profesionistët e linjës së parë besojnë se informacioni i pasaktë mund të ndikojë procesin e migrimit, si dhe ndikimin e pandemisë COVID-19 në fushën e migrimit. Për këtë anketë janë përzgjedhur profesionistët e linjës së parë të të gjithë sektorëve nga organizatat avokuese për migrim deri tek ekspertët e sigurisë së kufijve dhe ishte shtrirë në 14 vende e 11 gjuhë¹. Gjithsej janë realizuar 788 anketa prej të cilave 589 nga vendet evropiane (shumica prej të cilave nga Bullgaria, Itali dhe Spanja) dhe 199 nga vende jashtë Evropës (shumica e të cilave nga Algjeria). Mostra ishte relativisht e balancuar mes pjesëmarrësve që punojnë në çështjet kufitare dhe atyre në shërbimet mbështetëse të migrimit.

Gjetjet kryesore të anketës janë si në vijim:

- Profesionistët e linjës së parë të anketuar në masë dërrmuese kanë konsideruar faktorët e jashtëm (si dhuna, situatat e ndryshme politike, nivelet e ndryshme të mundësive etj.) dhe kushtet e përgjithshme negative në vendin e origjinës (si lufta, ekonomia e dobët etj.) si shkaktarët kryesorë të migrimit. Profesionistët nga vendet e përcaktuara si vende të transitit (Algjeria, Egjipti dhe Tunizia) kanë vlerësuar se kërcënimet e personave specifikë në vendet e origjinës (si persekutimit fetar etj.) janë veçanërisht të rëndësishëm në motivin për të migruar.
- Profesionistët konsideruan se migrantët kanë pikëpamje pozitive për Evropën dhe e vlerësuan këtë perceptim si mesatarisht të saktë. Megjithatë, ata i vlerësuan perceptimet e migrantëve për disa prej aspekteve të Evropës si relativisht më pak të favorshme. Perceptimi më pak pozitiv për sundimin e ligjit është një aspekt që duhet veçanërisht të analizohet ende më shumë.
- Profesionistët që kishin më shumë kontakte të drejtpërdrejta me migrantët i atribuuan saktësi më të madhe perceptimeve të migrantëve për Evropën lidhur me tolerancën dhe mosdiskriminimin, cilësinë e përgjithshme të jetës dhe të drejtat e grave.
- Shumica e të anketuarve nuk u pajtuan me konstatimin se migrantët që vijnë në Evropë në bazë të informatave të pasakta kanë më shumë gjasa të kryejnë krime apo të radikalizohen. Sidoqoftë, përgjigjet ishin shumë të polarizuara nga ana e profesionistëve nga gjinia mashkullore, atyre nga vendet e transitit dhe profesionistëve të organizatave ndërqeveritare që kishin më shumë gjasa të pajtohem me një besim të tillë.

¹ Vendet në të cilat u zhvillua anketimi ishin: Austria, Algjeria, Belgjika, Bullgaria, Qipro, Egjipti, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Kosova, Holanda, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar. Ndërsa, gjuhët në të cilat ishte zhvilluar anketimi ishin: shqip, arabisht, bullgarisht, holandisht, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht, italisht, rumanisht dhe spanjisht.

- Në përgjithësi, të anketuarit kishin tendencë për të besuar se migrantët që i marrin vendimet si pasojë e informatave të pasakta kanë më shumë gjasa të bien pre e kërcënimeve (si shfrytëzimi i rrugëve të rrezikshme ose kontrabanduesit e qenieve njerëzore), por jo se ata mund të paraqesin kërcënim tek shoqëritë e vendeve pritëse (përmes krimit dhe radikalizmit).
- Shumica e profesionistëve nuk besuan që situata me pandeminë COVID-19 ka shtruar nevojën për mbylljen e kufijve apo pezullimin e shërbimeve për migrantët. Megjithatë, përgjigjet lidhur me këtë çështje ishin shumë të polarizuara.
- Shumica e profesionistëve të linjës së parë që u anketuan i kanë konsideruar organizatat e tyre si efektive sa i përket punës së përgjithshme me migrantë dhe ofrimin e informatave të sakta për migrantët.
- Sidoqoftë, profesionistët identifikuan disa pengesa lidhur me efikasitetin e organizatave të tyre, me theks të veçantë në kufizime ligjore, burimet njerëzore të pamjaftueshme, stresin apo ngarkesat psikologjike të shkaktuara nga punët e kryera, pagat e pamjaftueshme për punët e kryera dhe mungesën e objekteve apo infrastrukturës së nevojshme.
- Pandemia COVID-19 ka zvogëluar kënaqshmërinë e profesionistëve me jetën e tyre, punën e tyre dhe ekuilibrin mes punës dhe jetës. Në kohën e realizimit të anketës, profesionistët ishin vetëm mesatarisht të kënaqur me pagën e tyre dhe njohjen sociale të punës së tyre.
- Profesionistët nuk ishin të kënaqur me politikat aktuale të migrimit të Bashkimit Evropian dhe të vendeve të tyre përkatëse. Profesionistët e linjës së parë që punojnë në organizatat joqeveritare (qoftë ato jofetare dhe fetare) ishin veçanërisht të pakënaqur në këtë drejtim.

The full report is available in English:

García-Carmona, M., García-Quero, F., Guardiola, J., Moya Fernández, P., Ollero Perán, J., Edwards, J., and Whitworth, B. (2021) Migration to the EU: a survey of first-line practitioners' perceptions during the COVID-19 pandemic. PERCEPTIONS project (Grant Agreement No 833870).

[Available here](#)



PERCEPTIONS